

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E Kryeministrit - UREDI Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Niveli Org. Org. Unit 02.22	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.: 1048
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages -05-	Data: Datum: Date: 27/04/2012
Prishtinë / a	



ANP - PIA "ADEM JASHARI" K.E.	
Nr./No. 407	
Dt. 23.04.2012	
Kodi / Code 1	
Prishtinë/a NG	

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NË MES TË:

KOMISIONIT PËR HETIMIN E AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE AERONAUTIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

N.P. AEROPORTI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS - ADEM JASHARI

Ky memorandum i mirëkuptimit përcakton mënyrën bashkëpunimit midis Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA) dhe Ndërmarrjes Publike Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) - Adem Jashari, me qëllim të garantimit të vazhdueshëm të sigurisë së aviacionit civil dhe hetimit adekuat të aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil në Kosovë, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil (Ligji), Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (Konventën e Çikagos), Marrëveshjen për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, dhe parimet e *acquis communautaire* të BE-së, të cilat janë të aplikueshme për sigurinë e aviacionit civil në Kosovë.

Ndërmarrja Publike ANP-Adem Jashari dhe KHAIA janë plotësisht të pavarura në kryerjen e veprimeve të tyre dhe ky memorandum nuk e cenon pavarësinë e veprimit të veçantë të secilës nga këto institucione.

1. Qëllimi i memorandumit

Ky memorandum mirëkuptimi (memorandumi) ka për qëllim ngritjen e bashkëpunimit në mes të autoritetit hetues të aksidenteve ajrore - KHAIA dhe ndërmarrjes publike ofruese të shërbimeve të navigacionit ajrore - NP ANP - Adem Jashari, në kuadër të fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara me ligj, të cilat paraqesin interes të përbashkët

2. Fusha e bashkëpunimit

Palët nënshkruese të këtij memorandumit pajtohen :

- 2.1 Të punojnë në mbikëqyrjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së aviacionit civil, promovimin e sigurisë dhe mbajtjen e besimit të publikut në sigurinë e aviacionit civil.
- 2.2 NP ANP - Adem Jashari, në pajtueshmëri me ligjin aktual në fuqi, do të zbatojë rregulloret e nxjerra nga KHAIA në lidhje me hetimin e aksidenteve dhe incidenteve aeronautike.
- 2.3 Në raste të aksidenteve apo incidenteve aeronautike, ANP - Adem Jashari koordinon përpjekjet e kërkimit dhe shpëtimit me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe bashkëpunon ngushtë, duke dhënë përkrahjen e nevojshme për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve aeronautike, me Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.
- 2.4 Roli i KHAIA si organ shtetëror hetues i pavarur i aksidenteve dhe incidenteve në aviacion nuk cenohet dhe ruhet pavarësia e institucionit në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
- 2.5 Incidentet apo aksidentet eventuale që mund të ndodhin në aviacion duhet të hetohen në mënyrë profesionale.
- 2.6 Rekomandimet për sigurinë e aviacionit civil të nxjerra nga KHAIA, do të trajtohen dhe zbatohen nga NP ANP - Adem Jashari sa më shpejt që një gjë e tillë të jetë e mundur.
- 2.7 Duhet të inkurajohet sa më shumë raportimi dhe hetimi i ndodhive (incidenteve dhe aksidenteve) me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve preventive dhe rritjes së sigurisë së aviacionit civil.

3. Përgjegjësitë e palëve

3.1 Komisioni për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve aeronautike (KHAIA)

KHAIA është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil brenda Kosovës dhe kur përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë, kudo qofshin ata.

3.2 NP ANP – Adem Jashari

NP ANP - Adem Jashari¹ është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të kontrollit të navigacionit ajror: (1) shërbimet e trafikut ajror, (2) komunikimet, (3) shërbimet e navigacionit dhe vëzhgimit, (4) shërbimet meteorologjike të navigacionit ajror, dhe (5) shërbimet e informimit aeronautik.

4 Reciprociteti i shërbimeve

- 4.1 NP ANP – Adem Jashari, pajtohet që, në rast se njoftohet për ndodhjen e ndonjë ndodhie, incidenti, incidenti serioz apo aksidenti, të lajmëroj KHAIA-n. Hetimi apo jo dhe niveli i hetimit për ndodhinë, incidentin apo aksidentin do të vendoset nga KHAIA. Kjo nuk e ndalon NP ANP – Adem Jashari të kryej hetime brenda ndërmarrjes për nevoja të veta.
- 4.2 NP ANP – Adem Jashari pajtohet, në rastet e ndonjë ndodhie, incidenti, incidenti serioz apo aksidenti, do t'i ofroj kopjet e dokumenteve dhe/ose dëshmitë, përmbajtjen e regjistruarve të komunikimit ndërmjet pilotit dhe kontrollorit, kur një gjë e tillë kërkohet me shkrim nga KHAIA.
- 4.3 NP ANP – Adem Jashari dhe KHAIA pajtohen që të synohet që raportimi i ndodhive të bëhet sa më shpejt online përmes softuerit për menaxhimin e raportimit të ndodhive ECCAIRS,
- 4.4 NP ANP – Adem Jashari dhe KHAIA pajtohen që, në kohë të përshtatshme për të dy palët, të mbajnë prezantime/ trajnime për stafin e njëra tjetrës, në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë ditore të tyre, si dhe t'i ofrojnë pjesëmarrje në trajnime, aty ku është e mundur, njëra tjetrës përfitues i të cilave trajnime mund të jetë cilado prej tyre.

¹ NP ANP – Adem Jashari është themeluar si ndërmarrje publike nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pas koncesionimit të ANP-së nga kompanitë Limak dhe Aeroport de Lion, dhe ka përgjegjësitë që kanë qenë detyrë e Departamentit të Ofrimit të Shërbimeve të Navigimit Ajrore të ANP-së para koncesionimit. Kjo ndërmarrje publike, pritet të shndërrohet në Agjencinë për Ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, pas miratimit të ligjit përkatës.

- 4.5 NP ANP – Adem Jashari zotohet që të caktoj një person brenda stafit të tyre, i cili do të mund të shërbej si pikë kontakti direkt për KHAIA-n dhe në raste të caktuar me udhëzim të KHAIA, ky person mund të kryej detyra të caktuar në emër të KHAIA deri në ardhjen e hetuesve të KHAIA. Personi kontaktues caktohet sipas nevojës nga Kryeshefi i ANP- Adem Jashari.
- 4.6 KHAIA pajtohet që në rast se përgatite ndonjë raport në lidhje me sigurinë e aviacionit civil në Kosovë ose raport për hetimin e ndonjë aksidenti apo incidenti ku involvohet stafi i NP ANP – Adem Jashari, ky raport do ti ofrohet NP ANP –Adem Jashari për mundësi të komentimit të tij para publikimit. Megjithatë, pa marrë parasysh paragrafin e mësipërm, KHAIA ruan të drejtën e mos-përfshirjes së komenteve të organizatave tjera, në raportet e saj
- 4.7 Rezultatet e hetimeve dhe rekomandimet e bëra nga hetimet e bëra nga KHAIA duhet të shërbejnë ekskluzivisht për përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së aviacionit dhe parandalimin e mundësisë së përsëritjes së incidenteve apo aksidenteve.

5 Mënyra e Komunikimit

Në rast të inicimit të hetimeve bazuar në ligjin për aviacionin civil (Ligji Nr. 03/L-051) nga ana e KHAIA-se ku involvohet edhe stafi i NP ANP – Adem Jashari, KHAIA është e obliguar të njoftoj me shkrim NP ANP – Adem Jashari për marrjen e provave, deklaratave, incizimin e komunikimeve etj., përveç rasteve emergjente kur ky njoftim nuk mund të bëhet me shkrim, ky njoftim bëhet nëpërmjet telefonit.

6 Dispozitat përfundimtare

- 6.1 Ky memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese të memorandumit.
- 6.2 Palët nënshkruese do të identifikojnë në mënyre permanente nevojën e avancimit të sigurisë të aviacionit civil dhe konform me këtë do të ndryshohet dhe plotësohet memorandum sipas nevojës.
- 6.3 Palët nënshkruese nuk synojnë që me këtë memorandum mirëkuptimi të krijojnë detyrime ligjore midis njëra tjetrës.

Palët nënshkruese

PËR KHAIA


NP ANP – ADEM JASHRI

Kreshnik Gashi



Kryesues i KHAIA

Bahri Nuredini



Kryeshef Ekzekutiv

Prishtinë 23.04.2012